

VENDIM
Nr. 59, datë 24.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/1 prot., datë 23.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Energy Market Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 877 prot., datë 16.02.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Duke qenë se konstatohet se vërtetimi për administratorin e shoqërisë është i lëshuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut, në vijim do t’i kërkohet që në rast se administratori është rezident në Shqipëri, të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore të lëshuar këtu.

- germa “c”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj në zbatim të kësaj pike të rregullores.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “a”: Duke qenë se shoqëria rezulton debitore ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, në vijim ajo duhet të bëjë me dije se si ka vijuar procesi i shlyerjes së detyrimit.

- germa “b”: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE disponimin e shumës që nevojitet për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe të depozitojë pasqyrat financiare për vitet 2021 dhe 2022.

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE Planin e Biznesit.

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Për dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti